

Rregullat e provimeve pranuese

Në ditët e provimeve duhet që:

- në ditën e provimit pranues, ju duhet të jeni në shkollë në orën 9:30;
- të keni dokument të identifikimit personal;
- gjësendet personale (çantë, telefona mobil, kalkulatorë) duhet t'i vendosni në vendin e paraparë për to;
- të kontrolloni testi a është në rregull gjatë kohës së paraparë përgatitore nga ora 10:00 gjer më 10:15;
- të lexoni udhëzimin për zgjidhjen e testit;

Është e lejuar:

- të konsumoni ujë ose pije të tjera joalkoolike;
- të përdorni paisje për shkrim (stilolaps);
- të përdorni paisje për gjeometri (laps, gomë, kompas, vizore);

Nuk është e lejuar:

- të përdorni fleta, telefona celularë, kalkulatorë dhe paisje të tjera elektronike;
- të konsultoheni ose të bisedoni me kandidatët tjerë;
- të përshkruani nga të tjerët ose të lejoni të përshkruajnë nga ju;
- të silleni në mënyrë të pahijshme me organizatorët e provimit ose me kandidatët e tjerë;
- të shënoni shenja të pahijshme ose përmbajtje nga testi ose në fletën e përgjigjeve;
- të shënoni shenja ose përmbajtje që asocojnë në identitetin e kandidatit;
- të mos e dorëzoni të plotë ose të pjesshëm materialin e provimit.